



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 848, DATË 21.06.2019 "PËR SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT PËR NDRYSHIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 85 DHE ZAZ-SË NR. 87, QARKU VLORË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 25.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shfuqizimin e vendimit nr. 848, datë 21.06.2019 "Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 85 dhe ZAZ-së nr. 87, Qarku Vlorë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019".

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1 germa "a", i ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 121, neni 127, i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet:

Nr.328 datë 14.05.2019, ka miratuar caktimin e VNV së KZAZ nr. 85 në Shkollën e Mesme "Hajredin Beqiri", palestra me sipërfaqe 231 m², Bashkia Selenicë.

Nr.329 datë 14.05.2019, ka miratuar caktimin e VNV së KZAZ nr.87, Kinoteatrin (Pallatin e Kulturës) me sipërfaqe 170 m², Bashkia Delvinë.



Nr. 862 i Vendimit Data 25.06.2019 e Vendimit Ora 13:00 e Vendimit

Për shfuqizimin e vendimit nr. 848, datë 21.06.2019 "Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 85 dhe ZAZ-së nr. 87, Qarku Vlorë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019".

Nr.848, datë 21.06.2019, pasi shqyrtoi propozimin e Prefektit të Qarkut Vlorë, shkresa nr.1976 datë 20.06.2019, vendosi ndryshimin e vendndodhjeve të:

VNV-së së ZAZ nr. 85 nga Shkolla e Mesme "Hajredin Beqiri", Bashkia Selenicë në Palestrën e Konviktit të Qytetit Studenti Vlorë;

VNV-së së ZAZ nr. 87 nga Kinoteatri (Pallatin e Kulturës) Bashkia Delvinë në Palestrën e Shkollës së Mesme "Hasan Tahsimi", Sarandë.

Prefekti i Qarkut Vlorë, me shkresën nr. 12289 prot, datë 25.06.2019, informon se ambientet në Palestrën e Konviktit të Qytetit Studenti Vlorë, dhe në Shkollën e Mesme "Hasan Tahsimi", Sarandë, me ndriçim të pamjaftueshëm dhe prezencë të dukshme të lagështirës, nuk ofrojnë kushte optimale për funksionimin e VNV-ve. Për këto shkaqe, si edhe në konsiderim të përmirësimit të situatës sa i përket zhvillimit të qetë të zgjedhjeve në datë 30.06.2019 në Bashkitë Selenicë dhe Delvinë, Prefekti i Qarkut Vlorë i kërkon KQZ-së që VNV e ZAZ nr. 85 dhe VNV e ZAZ nr. 87, të jenë sikundër janë caktuar fillimisht nga KQZ.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në analizë të kërkesës së paraqitur nga Prefekti i Qarkut Vlorë, vlerëson se:

Vendimi nr. 848, datë 21.06.2019, duke ndryshuar vendndodhjen e VNV së ZAZ 85 dhe ZAZ nr. 87, dhe caktuar ato jashtë juridiksionit territorial të ZAZ-ve, pavarësisht se në përputhje me përputhje me përcaktimet e nenit 94, pika 1, të Kodit Zgjedhor, rrit distancën e këtyre VNV-ve nga qendrat e votimit, ndryshim i cili nuk ndikon pozitivisht në lehtësitë logjistike për transportin e materialeve zgjedhore nga KZAZ në KQV dhe të materialeve të votimit nga KQV në KZAZ.

Përmirësimi i situatës në funksion të zhvillimit të procesit zgjedhor në Bashkitë Selenicë dhe Delvinë, ku ushtrojnë veprimtarinë KZAZ nr. 85 dhe KZAZ 87, krijon kushtet që objektet me vendndodhje në territoret e tyre të përdoren normalisht për qëllime zgjedhore.

Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, në:

nenin 121 "Nisma për shfuqizim ose revokim", pika 1, përcakton se aktet administrative shfuqizohen ose revokohen me nismën e organit kompetent ose si rezultat i kërkesës për shqyrtim apo apelimit të palëve të interesuara;

Nenin 122 "Revokimi dhe shfuqizimi i akteve të vlefshme", pika 2, gërma "b", përcakton se aktet administrative të vlefshme, përjashtimisht mund të revokohen ose shfuqizohen



Nr. 862 i Vendimit Data 25.06.2019 e Vendimit Ora 13:00 e Vendimit

Për shfuqizimin e vendimit nr. 848, datë 21.06.2019 "Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 85 dhe ZAZ-së nr. 87, Qarku Vlorë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019".

kur të gjitha palët e interesuara bien dakord për revokimin ose shfuqizimin e aktit, me kusht që akti të ketë krijuar të drejta të tilla nga të cilat mund të hiqet dorë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, është organi kompetent që mund të shfuqizojë vendimin nr. 848, datë 21.06.2019, për shkak të ndryshimit të rrethanave dhe kushteve të krijuara pas daljes së tij, shkaqe për të cilat ky akt nuk duhet t'i vazhdojë më efektet e tij juridike. Shfuqizimi i vendimit nr. 848, datë 21.06.2019, i cili nga ana e tij ka ndryshuar aktet e mëparshme, vendimet nr. Nr.328 dhe nr. 329, datë 14.05.2019, përtërin fuqinë ligjore të këtyre vendimeve duke e parashikuar në aktin shfuqizues.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 121, neni 127, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I

1. Të shfuqizojë vendimin nr. nr. 848, datë 21.06.2019 "Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 85 dhe ZAZ-së nr. 87, Qarku Vlorë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019".
2. Vendi i Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 85, do të jetë në Shkollën e Mesme "Hajredin Beqiri", palestra me sipërfaqe 231 m², Bashkia Selenicë, caktuar me vendimin nr.328 datë 14.05.2019.
3. Vendi i Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 87, do të jetë në Kinoteatrin (Pallatin e Kulturës) me sipërfaqe 170 m²", Bashkia Delvinë, caktuar me vendimin Nr.329 datë 14.05.2019
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement ZGURI Kryetar

Denar BIBA Zëvendëskryetar

Bledar SKËNDERI Anëtar

Edlira JORGAQI Anëtare

Rezarta BITRI Anëtare



Nr. 862 i Vendimit Data 25.06.2019 e Vendimit Ora 13:00 e Vendimit

Për shfuqizimin e vendimit nr. 848, datë 21.06.2019 "Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 85 dhe ZAZ-së nr. 87, Qarku Vlorë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019".